




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



OJQ ACI
z. Naim BREZNICA
Drejtore
Radio K
R023
Fushë Kosovë

N.SH. "Media 7 Kosova"
Nr. i biznesit 70795000
zgj. Enkelejda KUMARAKU
Pronare
z. Kushtrim AJVAZI
Person i Autorizuar
Prishtinë

Ref: 1404/533/KPM/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e pronësisë të Radio K – Komuna e Fushë Kosovës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio K është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në komunën e Fushë Kosovës. Radio K është pajisur nga KPM, me licencë afatgjatë të transmetimit me datën 6 tetor 2009.
3. Me datën 10 mars 2014, Radio K ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit përmes së cilës është kërkuar që të bartet pronësia nga OJQ "Association for Culture and Information in Fushë Kosovë/Kosovo Polje"(ACI) tek N.SH. "Media 7 Kosova" me pronare zgj. Enkelejda Kumaraku, shtetase e Shqipërisë.
4. Në bazë të udhëzimit të KPM-së, të datës 15 maj 2014, për plotësim të kërkesës me dokumentet përkatëse, kandidati për pronarë të ri i N.SH. "Media 7 Kosova" për licencë

të KPM-së, me datën 27 maj 2014 ka dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe ka plotësuar kërkesën e tij.

5. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së Radio K thuhet se, arsye për ndryshimin e pronësisë janë aktualisht kushtet jo të mira financiare të OJQ ACI, të cilat e vështirësojnë menaxhimin dhe zhvillimin e subjektit transmetues.
6. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë së Radio K është cekur se pronari i ri do të marrë përsipër obligimin vazhdimin të transmetimit të programit në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën rome dhe se skema programore në masën të madhe do të mbetet e njëjta si dhe nuk do të ketë ndryshime të stafit të radios, duke e ruajtur kështu strukturën programore dhe organizative sipas kategorisë multietnike të subjektit transmetues, ashtu sic është licencuar fillimisht nga KPM.
7. Kandidati për pronarë të ri të Radio K, e ka përfaqësuesin ligjor të N.SH. “Media 7 Kosova” i cili është shtetas i Republikës së Kosovës dhe i regjistruar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

Arsyetimi

8. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
9. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
10. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
11. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
12. Kërkesa për ndërrimin e pronësisë është parashtruar në pajtueshmëri të plotë me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dhe në pajtim me nenin 4 të rregullores për dhënien e licencës KPM- 2013/04 së.
13. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik.

14. KPM vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio K nuk do të ndikojë negativisht në ndryshimin e formatit të programit dhe nuk do të ketë ndryshime në zonë e mbulimit.
15. KPM vlerëson se kandidati për pronarë të ri të Radio K ka njohuri profesionale në menaxhimin e radio stacionit.

VENDIM

16. KPM merr vendim për ndryshimin e pronësisë së Radio K duke e bartur tek N.SH. "Media 7 Kosova" dhe licenca e Radio K të ndryshohet.

Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

11.06.2014
datë